



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1719/1 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM
Nr.257, datë 29.12.2017

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 74, DATË 29.06.2016,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË KAVAJË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 5, datë 18.01.2016, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kavajë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka urdhëruar fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në këtë subjekt. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja në institucionin e Bashkisë Kavajë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Kavajë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave të mëposhtme:

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, të rregullojë pasojat lidhur me rastet, në të cilat nuk janë respektuar kërkesat ligjore gjatë kryerjes së procesit të deklarimit të statusit të punësimit, pasi punonjësit e deklaruar me status, nuk i plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civil, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Konkretisht, bëhet fjalë për rastet e renditura në vijim:

a) Për punonjësin *****, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 1115/1, datë 01.07.2014 dhe aktin e konfirmimit si nëpunës civil me nr. 547, datë 20.04.2015, pasi ky punonjës, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nuk plotësonte kriterin arsimor, duke qenë se zotëronte diplomë “Bachelor”, në një kohë që për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Biznesit dhe të Ardhurave”, duhet niveli arsimor “Master shkencor”.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi *****, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”.
- Pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Biznesit dhe të Ardhurave” duhet të shpallet i lirë, për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.

b) Për punonjësin *****, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 1116/3, datë 01.07.2014, pasi ky punonjës, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, duke qenë se në atë moment ai zotëronte diplomë të nivelit “Bachelor”, në një kohë që për atë pozicion pune kërkohet niveli “Master shkencor”.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi *****, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

- Pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike” duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.
- c) Për punonjës të ***** njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:
- a. Të revokojë aktin nr. 1117/5, datë 01.07.2014, për deklarin “nëpunës civil në periudhë prove” dhe aktin nr. 555, datë 20.04.2015, për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin “Specialist Sporti”.
 - b. Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil në pozicionin “Specialist Sporti” dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi ***** nuk i përmbush kushtet për të qenë nëpunës civil, për shkak se është me arsim të mesëm.
 - c. Pozicioni i punës “Specialist Sporti” në Sektorin e Menaxhimit të Aktiviteteve të Kulturës dhe Rinisë në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve duhet të shpallet i lirë, për t`u plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.
- d) Për punonjës të ***** njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:
- d. Të revokojë aktin nr. 1117/6, datë 01.07.2014 për deklarin “nëpunës civil në periudhë prove” dhe aktin nr. 554, datë 20.04.2015 për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin “Specialist Sporti”.
 - e. Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil në pozicionin “Specialist Sporti” dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi ***** nuk i përmbush kushtet për të qenë nëpunës civil, për shkak se është me arsim të mesëm.
 - f. Pozicioni i punës “Specialist Sporti” në Sektorin e Menaxhimit të Aktiviteteve të Kulturës dhe Rinisë në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve duhet të shpallet i lirë, për t`u plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë lidhur me disa punonjës, të cilët nuk përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, për të cilët nuk ishte kryer deklarimi i statusit të punësimit, si më poshtë:
- *****; në pozicionin e punës “Inspektore në Sektorin e Ndihmës Ekonomike”;

- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Arkive”;
- ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Sporteve”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialiste Ushqimi dhe Veteriner”.
- ***** , në pozicionin e punës “Agronom”;
- ***** , punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
- ***** , punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
- ***** , punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të përfundimit të marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*
 - *Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t`u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.*
- 4.** *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë që të ndryshojë përmbajtjen e aktit administrativ kolektiv nr. 125, datë 13.08.2015 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, nga i cili duhet të hiqet punonjësi ***** , i cili ka qenë i punësuar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.*

Njësia përgjegjëse duhet të bëjë refuzimin e statusit si nëpunës civil dhe të nxjerrë aktin individual të ndërprejes së marrëdhënies së punës për këtë punonjës, duke cilësuar si motivacion largimin për faktin e mospërmbushjes së kriterit arsimor për të qenë nëpunës civil, në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- 5.** *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë të ndryshojë përmbajtjen e aktit administrativ kolektiv nr. 126, datë 13.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, të cilët kanë qenë të punësuar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.*

*Njësia përgjegjëse duhet të bëjë refuzimin e statusit si nëpunës civil dhe të nxjerrë aktin individual të ndërprejes së marrëdhënies së punës për punonjësit: ***** , ***** , dhe ***** , duke cilësuar si motivacion largimin për faktin e mospërmbushjes së kriterit arsimor për të qenë nëpunës civil, në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

6. Të plotësohen dosjet e personelit për punonjësit e punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (Njësisë Administrative) Luz i Vogël dhe të vijojë procesi i deklarimit të statusit të tyre të punësimit.
7. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, në kushtet e riorganizimit të institucionit, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.
8. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, të përfshijë në planin vjetor të rekrutimit edhe nevojat e njësisë administrative, subjekt mbikëqyrjeje, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”.
9. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë lidhur me rastet kur ka përdorur institutin e transferimit, në një kohë kur duhej të kishte vepruar në përputhje me procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, për punonjësit si më poshtë:
 - Për punonjësin *****, të revokojë aktin e transferimit (emërimin) nr. 32, datë 09.02.2015 dhe të rishikojë mundësinë e kthimit në pozicionin “Specialist”, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë. Pozicioni i punës “Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike” duhet të shpallet i lirë, për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
 - Për punonjësen *****, të revokojë aktin e transferimit nr. 152, datë 25.09.2015 dhe të rishikojë mundësinë e kthimit në pozicionin “Përgjegjës i Urbanistikës”, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë. Pozicioni i punës “Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave”, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
10. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë lidhur me rastet e emërimeve të përkohshme pa respektuar rregullat e pranimi në shërbimin civil, të kryera pas fillimit të efekteve juridike

të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për punonjësit e mëposhtëm:

- ***** – në pozicionin "Specialist i Pagave", në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin "Specialist Kontabiliteti", në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialiste Inxhinierë", në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist Mjedisi", në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist Veteriner", në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialiste Ushqimi", në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës "Inspektor Trafiku dhe Transporti", në Sektorin e Menaxhimit të Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës "Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore", në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist IT", në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist", në Sektorin e Marrëdhënies me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist", në Sektorin e Marrëdhënies me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist", në Sektorin Juridik, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës "Specialist Turizmi", në Sektorin e Menaxhimit të Aktiviteteve të Kulturës dhe Rinisë, në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve.
- ***** – në pozicionin e punës "Jurist", në Njësinë Administrative Luz i Vogël.

Për këto raste, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të revokojë aktet përkatëse të emërimit, dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësit me institucionin.
- Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Kavajë.

*11. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë që për punonjësën ***** të bëjë deklarin e statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil dhe të drejtat që i takojnë, në bazë të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në momentin e lirimimit nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi.*

12. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Kavajë, prej datës 01.01.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, ka nxjerrë vendimin nr. 30, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 74, datë 29.06.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Bashkisë Kavajë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.01.2016 e në vazhdim”.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilia Kukumi, Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Alda Xhaxhiu, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe Helga Peti, Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 20.03.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Kavajë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Kavajë, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 109/2 prot., datë 10.02.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 20.03.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Kavajë, Drejtori i Drejtorisë Ligjore, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga grupi i punës, i cili materializonte zbatimin e Vendimit Nr. 74, datë 29.06.2016, rezultoi se ky vendim nuk ishte zbatuar në një masë të konsiderueshme. Për këtë arsye, Komisioneri e vlerësoi të nevojshme verifikimin e mëtejshëm të veprimtarisë së institucionit për zbatimin tërësisht të vendimit në fjalë, duke e njoftuar këtë të fundit me shkresën Nr. 1719 Prot., datë 25.10.2017, “*Njoftim mbi procesin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 74, datë 29.06.2016, të Komisionerit*”. Dokumentet shtesë, të administruara nga grupi i punës janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në datën 16.11.2017.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se nga ana e institucionit në lidhje me rekomandimet e Komisionerit janë kryer veprimet si më poshtë:

Në pikën 2 të vendimit të Komisionerit është kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë që të rregullojë pasojat lidhur me rastet, në të cilat nuk janë respektuar kërkesat ligjore gjatë kryerjes së procesit të deklarimit të statusit të punësimit, duke vendosur revokimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimit dhe konfirmimit si nëpunës civil, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësit *****, ***** dhe *****.

Nga administrimi i dokumenteve pranë këtij institucioni rezultoi se, nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kavajë nuk ishte marrë asnjë masë për revokimin (anulimin) e aktit nr. 1115/1, datë 01.07.2014, të deklarimit të statusit të punësimit dhe aktit nr. 547, datë 20.04.2015, të konfirmimit si nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Biznesit dhe të Ardhurave*”, dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin *****. Në shkresën Nr. 3087/1 Prot., datë 01.12.2016, “*Kthim përgjigje*”, drejtuar Komisionerit, Bashkia Kavajë pretendon se punonjësi ***** nuk është liruar nga shërbimi civil pasi në çastin e konfirmimit të statusit të nëpunësit civil, ai zotëronte diplomën “*Master Shkencor*” dhe ka të mbrojtur gjuhën angleze por në momentin e verifikimit në subjekt, njësia përgjegjëse nuk zotëronte asnjë dokument që të mbështeste këtë pretendim.

Me Urdhrin Nr. 220, datë 16.08.2017, “*Për lirim nga detyra*”, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë (të administruar nga grupi i punës), punonjësi ***** është liruar nga detyra “*Specialist për Taksën Familjare*”, në bazë të kërkesës së tij për dorëheqje. Konstatohet se, në momentin e daljes së këtij akti ky punonjës mbante pozicionin “*Specialist për Taksën Familjare*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Pas verifikimit në institucion, nuk u paraqit asnjë akt që të vërtetonte emërimin e punonjësit ***** në këtë pozicion në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nisur nga fakti, që pozicioni, “*Specialist për Taksën Familjare*”, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, referuar VKM Nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, emërimi në këtë pozicion pune duhej bërë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele apo pranimit në

shërbimin civil, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimet në kategorinë ekzekutive”.

Nga sa më sipër vërej se, nuk rezulton që këto procedura të jenë zbatuar, çka e ka thelluar më tej situatën e paligjshmërisë për këtë rast. Akti i emërimit të punonjësit ***** në këtë pozicion, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm referuar neneve 108 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe si i tillë ai nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar ose jo si i tillë. Për këtë arsye, bazuar në dispozitat e cituara në sipër, Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe njësia përgjegjëse duhej të kishin marrë masat për konstatimin e pavlefshmërisë absolute dhe anulimin e tij dhe jo të shpreheshin për largimin e punonjësit për shkak të dorëheqjes.

Për 3 rastet e tjera, konkretisht për punonjësit: ***** në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, ***** dhe ***** në pozicionin “Specialist Sporti, konstatohet se nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe njësisë përgjegjëse janë nxjerrë aktet administrative për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë si dhe aktet për revokimin e statusit me motivacionin për mospërbushje të kriterëve për nëpunësin civil, si më poshtë:

- a. Akti nr. 1471/1 prot., datë 22.12.2016, për revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr. 1116/3 prot., datë 01.07.2014, për punonjësin ***** në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike”. Me aktin nr. 84, datë 30.05.2016, ky punonjës ka kaluar në pozicionin “Zëvendëskryetar i Bashkisë Kavajë”, pozicion pune jashtë shërbimit civil.
- b. Akti nr. 3506 prot., datë 30.12.2016, për revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr. 1117/5 prot., datë 01.07.2014, për punonjësin ***** në pozicionin “Specialist Sporti”. Me aktin nr. 3506/1 prot., datë 30.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur refuzimin e statusit të nëpunësit civil, për shkak të mospërbushjes së kriterit arsimor dhe me aktin nr. 138, datë 30.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur revokimin e aktit nr. 555 prot., datë 20.04.2015, për konfirmimin si nëpunës civil. Referuar listëpagesës së muajit shkurt 2017, rezulton se ky punonjës është larguar nga detyra që kryente si “Specialist Sporti”.
- c. Akti nr. 3507 prot., datë 30.12.2016, për revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr. 1116/6 prot., datë 01.07.2014, për punonjësin ***** në pozicionin “Specialist Sporti”. Me aktin nr. 3507/1 prot., datë 30.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur refuzimin e statusit të nëpunësit civil, për shkak të mospërbushjes së kriterit arsimor dhe me aktin nr. 139, datë 30.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur revokimin e aktit nr. 554 prot., datë 20.04.2015, për konfirmimin si nëpunës civil. Referuar listëpagesës së muajit shkurt 2017, rezulton se ky punonjës është larguar nga detyra që kryente si “Specialist Sporti”.

Pavarësisht parregullsive të evidentuara më sipër, duke qenë se pasojat janë zgjidhur, për faktin se punonjësit janë larguar nga shërbimi civil, kjo pikë e dispozitivit të vendimit të Komisionerit do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen Kryetarit të Bashkisë dhe njësisë përgjegjëse që në të ardhmen të zbatojnë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, është kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë të nxjerrë aktet e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të përfundimit të marrëdhënies së punësimit në pozicionet përkatëse për 8 punonjës duke evidentuar faktin se nuk përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë.

Nga analiza dhe shqyrtimi i akteve rezultoi sa më poshtë:

- ✓ Me aktin nr. 3504 prot., datë 30.12.2016 është bërë refuzimi i deklaramit të statusit të punësimit për punonjësen ***** në pozicionin *Inspektor* në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe me aktin nr. 288, datë 24.08.2017, “*Për lirim nga detyra*”, është bërë ndërprerja e marrëdhënieve financiare në këtë pozicion.

Më tej, me aktin nr. 380/1 prot., datë 01.02.2017, ***** është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove në të njëjtin pozicion pune. Ndërkohë nga shqyrtimi i akteve që materializojnë procedurën e konkurrimit, vërehen mangësi dhe parregullsi të theksuara procedurale.

Konkretisht, për këtë procedurë nuk u paraqit asnjë akt që vërteton krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimiit për nivelin ekzekutiv dhe as akti i shpalljes për plotësim të pozicionit të lirë të punës, ku të jenë specifikuar në mënyrë të qartë të dhënat, e përcaktuara në pikën 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimiit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja. Mosrespektimi i këtyre elementëve të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në finalizimin e veprimiit administrativ, shpalljes së kandidatit fitues në përfundim të procedurës së konkurrimit, passjell pavlefshmërinë absolute të saj.

Njëkohësisht, akti i publikimit të kandidatit fitues nr. 28/1 prot., dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, mban datën 09.02.2017, pra 8 ditë pas nxjerrjes së aktiit të emërimit për këtë punonjëse, çka të krijon dyshimin se procedura e konkurrimit në këtë rast është kryer në mënyrë fiktive.

Për arsyet e mësipërme, akti i emërimit nr. 380/1 prot., datë 01.02.2017, për punonjësen *****, në pozicionin *Inspektor* në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, bazuar në nenin 108 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duhet të anulohet, si akt absolutisht i pavlefshëm.

- ✓ Me Urdhrin nr. 13, datë 24.01.2017, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë për vitin 2017*”, pozicioni “*Specialist Arkivi*”, që mbante punonjësja ***** ka ndryshuar emërtesë në “*Punonjëse Arkivi*” (ndërkohë në këtë strukturë nuk është bërë një klasifikim i qartë i pozicioneve të shërbimit civil dhe atyre jashtë shërbimit civil, nuk janë përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori apo kategori e pagës, sikundër parashikohet në Vendimin Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”. Për më tepër, mungesa e përshkrimeve të punës e bën akoma më të vështirë klasifikimin e saktë të këtij pozicioni kundrejt shërbimit civil). Më tej, me Urdhrin nr. 427, datë 06.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, kjo punonjëse është liruar nga detyra në bazë të kërkesës së saj për dorëheqje.
 - ✓ Me Urdhrin nr. 77, datë 24.05.2016, Kryetari i Bashkisë Kavajë ka bërë emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Punonjës Sporti*”, në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve, pozicion pune i cili nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimit civil. Me aktin nr. 4941 prot., datë 14.11.2017, njësia përgjegjëse ka vendosur refuzimin e statusit të nëpunësit civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Sporteve*”.
 - ✓ Me aktin nr. 3463 prot., datë 28.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur shfuqizimin e urdhrit të punësimit nr. 63, datë 10.06.2013, në pozicionin “*Specialiste e Ushqimit dhe Veteriner*”, për punonjësen *****. Referuar listëpagesës së muajit shkurt 2017, rezulton se kjo punonjëse është larguar nga detyra e mësipërme.
 - ✓ Punonjësi ***** ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.
 - ✓ Për punonjësit ***** dhe ***** nga ana e njësisë përgjegjëse është bërë vetëm refuzimi i statusit të nëpunësit civil, përkatësisht me shkresën nr. 3112 prot., datë 21.11.2016, për punonjësën ***** dhe me shkresën nr. 3113/2 prot., datë 21.11.2016, për punonjësën *****.
- Në nenin 44, germa “j”, të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, (ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar*”), përcaktohet se: “*Kryetari i komunës ose bashkisë: j) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive administrative/lagjeve.*”. Duke qenë se tashmë, funksioni i

administratorit të njësive administrative ka dalë jashtë shërbimit civil, rekomandimi i Komisionerit për këto dy punonjës do të konsiderohet i zbatuar.

- ✓ Me aktin nr. 3112/1 prot., datë 21.11.2016, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kavajë ka vendosur refuzimin e statusit të nëpunësit civil për punonjësin ***** , për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Më tej, me Urdhrin nr. 47, datë 24.03.2017, Kryetari i Bashkisë Kavajë ka bërë emërimin e këtij punonjësi në pozicionin “*Punonjës i Bujqësisë*”, në Njësine Administrative Helmas, pozicion pune i cili nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në periudhën nga data e nxjerrjes së aktit të refuzimit të statusit të nëpunësit civil më 21.11.2016 deri në emërimin e këtij punonjësi në pozicionin e punës “*Punonjës i Bujqësisë*” më datë 24.03.2017, referuar listëpagesës së muajit shkurt 2017 rezultojnë se ky punonjës ka vazhduar marrëdhënien e punësimit në pozicionin “*Agronom*”, pranë Njesisë Administrative Helmas, në kundërshtim të hapur me ligjin.

Në kushtet kur punonjësi nuk i plotësonte kriteret e posacme të vendit të punës, për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës e parashikuar në pikën 7, kreu III të Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

Pavarësisht parregullsive të evidentuara më sipër, vlerësoj se, duke qenë se tashmë pasojat janë zgjidhur, për shkak se punonjësi ***** ka kaluar në pozicion pune jashtë shërbimit civil, rekomandimi i Komisionerit për këtë rast do të konsiderohet i zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen Kryetarit të Bashkisë dhe njesisë përgjegjëse që në të ardhmen të zbatojnë me përpikmëri ligjin dhe vendimet e Komisionerit.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve në pikën 4 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, në të cilën është kërkuar ndryshimi i aktit kolektiv nr. 125, datë 13.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë pune, duke nxjerrë aktin individual të përfundimit të kësaj marrëdhënieje për punonjësin ***** , i cili ka qenë i punësuar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, si dhe aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil, njësia përgjegjëse, me aktin nr. 3112/3 prot., datë 21.11.2016, ka vendosur refuzimin e statusit të nëpunësit civil për këtë punonjës, për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Më tej, me aktin nr. 142, datë 30.12.2016, “*Për largim nga puna*”, kjo njësi ka nxjerrë aktin individual të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësin në fjalë.

Po kështu, ***në pikën 5 të vendimit*** të Komisionerit është kërkuar ndryshimi i përmbajtjes së aktit administrativ kolektiv nr. 126, datë 13.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës me kontratë

pune, të cilët kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duke nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe aktin individual të përfundimit të kësaj marrëdhënieje për punonjësit ***** , ***** dhe *****.

Në zbatim të këtij rekomandimi, konstatohet se, njësia përgjegjëse ka vendosur refuzimin e statusit si nëpunës civil për arsye se nuk përmbushin kriterin arsimor për punonjësit: Brunilda Lila me aktin nr. 3508 prot., datë 30.12.2016; Xhavit Istrefi me aktin nr. 3509 prot., datë 30.12.2016 dhe ***** me aktin nr. 3510 prot., datë 30.12.2016. Më tej, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet individuale të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësit e mësipërm: aktin nr. 103, datë 26.07.2016, për punonjësen ***** , aktin nr. 143, datë 30.12.2016 për punonjësin ***** dhe aktin nr. 144, datë 30.12.2016, për punonjësin *****.

Në pikat 6 dhe 7 të vendimit të Komisionerit, është kërkuar nga njësia përgjegjëse që të plotësojë dosjet e personelit të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (Njesisë Administrative) Luz i Vogël, duke vijuar me procesin e deklaramentit të statusit të tyre të punësimit, si dhe të hartojë përshkrimet e punës për pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*.

Nga procesverbali i mbajtur në subjekt, konstatohet se këto rekomandime nuk janë zbatuar, pasi nga njësia përgjegjëse pretendohet se institucioni ndodhet në proces rristrukturimi.

Në zbatim të pikës 8 të vendimit paralajmëruet të Komisionerit njësia përgjegjëse, me aktin nr. 273/1 prot., datë, 28.02.2017, *“Për miratimin e Planit Vjetor të Pranimeve në Shërbimin Civil në Bashkinë Kavajë”*, ka përfshirë në planin vjetor të rekrutimit edhe nevojat e njësive administrative, sipas kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” (pavarësisht, faktit që vendimi i sipërcituar daton më herët se vendimi i Komisionerit, në momentin e mbikëqyrjes ai nuk i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes)*.

Në pikën 9 të vendimit të Komisionerit është kërkuar nga njësia përgjegjëse që të revokojë aktet e transferimit të punonjësve ***** dhe ***** , për shkak se ka përdorur institutin e transferimit, në një kohë kur duhej të kishte vepruar në përputhje me procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe rishikimin e mundësisë për rikthimin e tyre në pozicione të së njëjtës kategori me atë që kanë pasur para transferimit.

Nga aktet e administruara gjatë verifikimit në subjekt, konstatoj se, me aktin nr. 15, datë 27.05.2016 dhe nr. 19, datë 27.05.2016, njësia përgjegjëse i ka emëruar punonjësit ***** dhe ***** respektivisht në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori me atë që kanë pasur përpara transferimit (***** në pozicionin *Specialist i Pagave në Sektorin e Buxhetit dhe Financës dhe ***** në pozicionin Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Projektimit*).

Më tej, me aktin nr. 140, datë 30.12.2016, njësia përgjegjëse ka vendosur revokimin e aktit të transferimit nr. 32, datë 09.02.2015, të punonjësit ***** në pozicionin *“Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Financës”* dhe me aktin nr. 141, datë 30.12.2016, ka vendosur revokimin e aktit të transferimit nr. 152, datë 25.09.2015, të punonjësës ***** në pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave”*.

Nga sa më sipër, vërej se, aktet nr.140, datë 30.12.2016 dhe nr.141, datë 30.12.2016, me anë të të cilëve janë revokuar aktet e transferimit për këta dy punonjës janë nxjerrë 7 muaj pas daljes së akteve të emërimit të tyre në pozicione të së njëjtës kategori me atë që kanë pasur përpara transferimit. Në kushtet kur kalimi i këtyre punonjësve në pozicione të një niveli më të lartë nëpunësie është bërë në shkelje flagrante të dispozitave të ligjit të posaçëm, çka passjell pavlefshmërinë absolute të këtij veprimi administrativ, fillimisht duhej të procedohej me revokimin (apo anulimin në kushtet kur tashmë kishte hyrë në fuqi kodi i ri i procedurave administrative) e akteve administrative të transferimit e më tej të nxirreshin aktet për emërimin e punonjësve në pozicionet e sipërcituara.

Sa më sipër, Kryetari i Bashkisë dhe njësia e menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kavajë duhet të mbajnë parasysh që kjo parregullësi të mos përsëritet më në të ardhmen.

Në vendimin paralajmëruar të Komisionerit, **në pikën 10** të tij, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë lidhur me rastet e emërimeve të përkohshme pa respektuar rregullat e pranimit në shërbimin civil, të kryera pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Konkretisht, njësia përgjegjëse duhej të revokonte aktet e emërimit dhe të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit, duke shpallur të lira pozicionet e punës të mbajtura nga punonjësit e mëposhtëm:

- ***** – në pozicionin *“Specialist i Pagave”*, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin *“Specialist Kontabiliteti”*, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin e punës *“Specialiste Inxhinierë”*, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike.
- ***** – në pozicionin e punës *“Specialist Mjedisi”*, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist Veteriner*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialiste Ushqimi*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës “*Inspektor Trafiku dhe Transporti*”, në Sektorin e Menaxhimit të Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- ***** – në pozicionin e punës “*Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist IT*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin Juridik, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ***** – në pozicionin e punës “*Specialist Turizmi*”, në Sektorin e Menaxhimit të Aktiviteteve të Kulturës dhe Rinisë, në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve.
- ***** – në pozicionin e punës “*Jurist*”, në Njësinë Administrative Luz i Vogël.

Në lidhje me këto raste, konstatoj se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë revokuar aktet e emërimit për asnjë nga punonjësit e sipërcituar. Dy nga punonjësit e mësipërm ishin larguar nga shërbimi civil, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes. Konkretisht:

- ***** , larguar nga pozicioni i punës “*Specialist Veteriner*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me Urdhrin nr. 15, datë 15.03.2016, “*Për largim nga detyra*”. Pavarësisht faktit që akti i sipërcituar daton më herët se vendimi i Komisionerit, në momentin e mbikëqyrjes ai nuk i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes.
- Megi Katroshi, larguar nga pozicioni i punës “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Urdhrin nr. 99, datë 20.07.2016, “*Për largim nga detyra*”.

Për punonjësin ***** , me detyrë “*Jurist*”, në Njësinë Administrative Luz i Vogël, njësia përgjegjëse, në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, ka nxjerrë Urdhrin nr. 145, datë 30.12.2016, “*Për largim nga detyra*”.

Për 11 punonjësit e tjerë të përmendur më sipër, njësia përgjegjëse nuk kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Nga aktet e administruara nga grupi i punës, konstatoj se, me shkresat nr. 409 prot., datë 15.02.2016, “*Dërgim dokumentesh për publikim të vendit vakant*”, nr. 1256 prot., datë 11.05.2016, “*Dërgim dokumentesh për publikim të vendeve vakante*”, nr. 2674 prot., datë 29.09.2016, “*Kërkesë për shpallje të vendeve vakante*” dhe nr. 1646 prot., datë 29.05.2017, “*Dërgim dokumentesh për publikim të vendit vakant*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ishin shpallur të lira pozicionet e mëposhtme:

- “*Specialist i Pagave*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1761/2 prot., datë 24.06.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësi *****.
- “*Specialist Kontabiliteti*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1760/2 prot., datë 24.06.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****.
- “*Specialiste Inxhinierë*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1762/2 prot., datë 24.06.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****.
- “*Specialist IT*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1764/2 prot., datë 24.06.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësi *****.
- “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1766/2 prot., datë 24.06.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****.
- “*Specialist*”, në Sektorin Juridik, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 803/2 prot., datë 31.03.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****.
- “*Specialist Mjedisi*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 3055/2 prot., datë 11.11.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësi *****.
- “*Inspektor Trafiku dhe Transporti*”, në Sektorin e Menaxhimit të Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 3054/2 prot., datë 11.11.2016, në këtë pozicion është emëruar punonjësi *****.
- “*Specialiste Ushqimi*”, në Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 2226/1 prot., datë 12.07.2017, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****.

Punonjësja *****, emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës “Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore”, në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1767/2 prot., datë 24.06.2016, është emëruar në pozicionin “Specialist Pronash”, në Sektorin e Hartografisë, Regjistrimit të Pronave Publike, Kadastrës dhe GIS Projekteve, në Drejtorinë e Kadastrës Urbane.

Punonjësi *****, me aktin nr. 1946/2 prot., datë 12.07.2016, është emëruar në pozicionin “Specialist Turizmi”, i shpallur vakant me shpalljen Nr. 1504 prot., datë 01.06.2016, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ky është i vetmi akt i vënë në dispozicion të grupit të punës që materializon procedurën e konkurrimit për këtë rast). Më tej, me aktin nr. 81, datë 31.05.2017, të Bashkisë Kavajë, ky punonjës është larguar nga shërbimi civil, bazuar në kërkesën e tij për dorëheqje.

Në zbatim të pikës 11 të vendimit të Komisionerit rezulton se për punonjësin *****, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit nr. 3112/4 prot., datë 21.11.2016, duke e deklaruar këtë nëpunës si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik”.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Bashkisë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, konstatoj se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Kavajë janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar. Mbështetur në analizën e bërë më sipër, pikat 3 (rasti i *****), 6 dhe 7 të këtij vendimi do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e zbatimit të pjesshëm të Vendimit Nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 3, (rasti i *****), 6 dhe 7 të vendimit Nr. 74, datë datë 29.06.2016.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Kavajë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha